



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 07.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.07.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "STONE STRONG" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore ", Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "STONE STRONG " SH.P.K., e dt.02.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore ", Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 03.07.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Përmirësohet** pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 03.07.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "STONE STRONG " SH.P.K., me dt.02.07.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore ", Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 07.07.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimi juaj lidhur me pikën 3, të aneksit 7 të dosjes së tenderit, është i pabazuar dhe mbetet i pandryshuar;
- Pretendimi juaj lidhur me pikën 9, të aneksit 7 të dosjes së tenderit, është i bazuar, dhe kjo pikë do të hiqet nga dosja e tenderit;
- Pretendimi juaj lidhur me pikën 12, të aneksit 7 të dosjes së tenderit, është i bazuar, dhe kjo pikë do të hiqet nga dosja e tenderit;
- Pretendimi juaj lidhur me pikën 13, është i pabazuar dhe mbetet i pandryshuar;
- Pretendimi juaj lidhur me pikën 16, të aneksit 7 të dosjes së tenderit, është i bazuar dhe Autoriteti kontraktues do të bëjë përmirsimin e dosjes së tenderit;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

